

Shoqeria *BIOMETRIC ALBANIA*shpk
Kapitali i neneshkruar 100 000 000 leke

RAPORT I VECANTE I EKSPERTIT

Per zmadhim kapitali te shoqerise *BIOMETRIC ALBANIA*SH.P.K .

Tirane

Me vendim te mbledhjes se Asamblese se Ortakut te vetem numer__ date 25.08.2022 te Shoqerise*BIOMETRIC ALBANIA*SH.P.K me seli ne Tirane , jam caktuar si ekspert per te perpiluar raportin e vecante ne lidhje me zmadhimin e kapitalit duke u nisur nga gjendja faktike e pasurise se Shoqerise ne fund te vitit 2021. Zmadhimi i kapitalit do te kete si burim fitimet e Shoqerise deri ne fund te vitit 2021.

Une ,Bujar Osmani, me cilesine e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabel te Regjistruar) ,i licensuar me license profesionale nr.70 dt 31.01.2000 te Komisionit te Regjistrimit prane IEKA-s,pranova misionin e percaktuar nga Asambleja e Ortakut te vetem te Shoqerise * BIOMETRIC ALBANIA *shpk me procedura te dakortesuara.

Me cilesine e Ekspertit per te bere kete Raport te Vecante per zmadhimin e kapitalit te shoqerise jemi mbeshtetur ne keto dokumenta:

1. Dokumenta ligjore

- Vendim i Gjykates per regjistrimin ne regjistrin tregtar te shoqerise si dhe vendimet e tjera gjyqesore.

- Statut dhe Akt-themelimi te Shoqerise

- Certifikata e regjistrimit ne organin Tatimor me kod Fiskal.

- Numri i identifikimit te personit Tatueshem.

- Vendimin e asamblese se Ortakut te vetem per emerimin si Ekspert.

2. Dokumenta Ekonomik .

- Bilancin e vitit ushtrimor 2021.

Ne inventaret Kontabel te aktiveve dhe pasiveve te perpiluara nga shoqeria e te rishikuara nga ana e jone mbi vleresimin e tyre.

- Cdo dokument apo informacion i kerkuar nga ana e jone ne mbeshtetje te ketij raporti.



Bilanci i vitit te ushtrimit 2021 i shoqerise * BIOMETRIC ALBANIA*shpk me seli ne Tirane i perpiluar nga shoqeria dhe i verifikuar nga ana jone perben bazen e ketij raporti.

Duke u nisur nga dokumentat e kontrolluara dhe te vertetuara, kontabilizimet, ne pozicionin e duhur, rezulton se ne Pasiv te bilancit, ne grupin e Kapitaleve te Veta fitimet e pashperndara deri me 31.12.2021 paraqiten si vijon:

- fitime te vitit ushtrimor	159 770 721 leke.
Totali	159 770 721 leke

Asambleja e Ortakut te vetem, me vendimin date 15.06.2022 ka vendosur qe fitimet e vitit 2021 ne shumen 159 770 721 leke, ti caktoje si vijon;

- 30 000 000 leke te kaloje per zmadhim te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.
- 129 770 721 leke ti shperndahen dividend ortakut te vetem.

Si rezultat i ketyre veprimeve dhe i vendimit te Asamblese se ortakeve ne ngjarjet ekonomike te shoqerise kryhet ky veprim Kontabel:

Debi llogaria * fitime te vitit ushtrimor*	159 770 721 leke
--	------------------

Kredi llogaria *Kapitali i nenshkruar	30 000 000 leke
Kredi llogaria * ortak dividend*	129 770 721 leke.

Ne perfundim te ketij veprimi Kontabel Grupi i Kapitaleve te neneshkruar te bilancit te shoqerise do te reformohet si me poshte:

Ne perfundim Shoqeria * BIOMETRIC ALBANIA *SH.P.K do te beje zmadhimin e kapitalit ne shumen 30 000 000 leke dhe ne total kapitali i neneshkruar i Ortakeve eshte :

Kapitali para zmadhimit	100 000 000 leke
Shtese kapitali	30 000 000 leke
Totali	130 000 000 leke

Kapitali themeltar prej 130 000 000 lekesh zoterohet si vijon:



- Z.Artur KADAREJA zoteron 1 (NJE) kuote me vlere nominale te kuotes 130 000 000 leke ose 100% te kapitalit themeltar .

Ky raport u behet i njohur Asamblese se Ortakut te vetem te Shoqerise dhe Administratorit te saj per te kryer veprimet e duhura ne kontabilitet dhe ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit .

AUDITUESI LIGJOR

Bujar OSMANI



Me02.09.2022

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE
"BIOMETRIC ALBANIA" sh.p.k
NIPT J61827062E

V E N D I M
date 23.08.2022
i Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise

Sot me date 23.08.2022, asambleja e ortakut te vetem te shoqerise
"BIOMETRIC ALBANIA" sh.p.k ne perputhje me statutin dhe ligjin

V E N D O S I

1. Te filloje procedurat ligjore per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 30 000 000 leke,nga fitimi i pashperndare deri ne fund te vitit 2021.
3. Te emeroje z.Bujar OSMANI,auditues ligjor me nr license 70 date 31.01.2000 , te pergatise raportin dhe modalitetet e zmadhimit te kapitalit.
4. Depozitim in e ketij Vendimi ne Qendren Kombetare te biznesit dhe vazhdimin e procedurave per rritjen e kapitalit.
5. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKU I VETEM

Artur KADAREJA

"BIOMETRIC ALBANIA"
SH.P.K.
MEDICAL EQUIPMENT
REAGENT MATERIALS - TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE
"BIOMETRIC ALBANIA" shpk
NIPT J61827062E

V E N D I M
DATE 06.09.2022

i Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise "BIOMETRIC ALBANIA"
sh.p.k

Sot me date 06.09.2022 Asambleja e ortakut te Vetem te shoqerise "BIOMETRIC ALBANIA" shpk , pasi lexoji dhe shqyrtoi raportin e Audituesit Ligjor per Rritjen e kapitalit te shoqerise:

V E N D O S I

1. Te miratoje raportin e Audituesit Ligjor z. Bujar OSMANI per rritjen e kapitalit te shoqerise.

2. Te miratoje shtesen e kapitalit ne shumen 30 000 000 leke , duke arritur kapitali themeltar i shoqerise ne vleren 130 000 000 leke, e ndare me kontributin e ortakeve si me poshte:

- Artur KADAREJA zoteron nje kuote me vlere nominale te kuotes 130 000 000 leke ose 100% te kuotave te kapitalit .

3 Depozitimimin e ketij Vendimi dhe te raportit te Audituesit Ligjor per rritjen e kapitalit prane Qendres Kombetare te Biznesit.

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "BIOMETRIC ALBANIA" sh.p.k

Artur KADAREJA

"BIOMETRIC ALBANIA",
SH.P.K.
MEDICAL EQUIPMENT
REAGENT MATERIALE - TIRANE